

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 280119
 Datë/Datum. 03.06.19

PRISHTINË - PRIŠTINA

ANKESË

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: Organi Shqyrtues i Prokurimit

Për Aktivitetin e Prokurimit: "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt-projekt 3 vjeçar"

Nr i Prokurimit	615-17-3827-5-1-1
Nr i brendshëm	616-115-511

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK : "NTP Begisholli & Conex Gruop"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
 Fsh. Varosh-Ferizaj

(Adresa)

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit) 049 785998

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj) Mejd Begisholli

(Adresa elektronike) begisholli & live.com

29.05.2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)

Begisholli
 (Nënshkrimi dhe vulë)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-Njoftimi për kontratë në KRPP është bërë me 15.08.2017.
-Afati i fundit për dorëzimin ofertave ka qenë me dt.26.09.2017 dhe hapja është bërë me të njejtën ditë.
-Lloji i kontratës punë vlerë e madhe
-Njoftimi për dhënie të kontratës me dt.21.11.2017.
-Vendimi për ri-vlerësim nga OSHP me dt.27.12.2017.
-Anulimi i këtij aktiviteti me dt.14.05.2019.
-Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.20.05.2019.
-Vendimi për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim 22.05.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Bazuar në nenin 109 të LPP parashtrojmë amkesë kundër vendimit të AK me të cilin vendim refuzohet kërkesa jonë për ri-shqyrtim për tenderin " Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt- projekt 3 vjeçar " me nr.të prok. 615-17-3827-5-1-1

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e njoftimit e dhënies së kontratës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenëve të LPP-së si më poshtë:

Nenin 1,

Neni 6,

Neni 59,

Neni 62,

Neni 72,

Nenit 108A dhe

Neni 115.6

Nenin 39.8 të RUOPP

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si OE me dt.20.05.2019 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK lidhur me tenderin "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt- projekt 3 vjeçar " me nr.të prok. 615-17-3827-5-1-1.AK me dt.14.05.2019 ka anuluar kë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se një dispozit e LPP kërkon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Të pa knaqur me këtë anulim kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim dhe atë me dt.20.05.2019 me pretendimin se është vepruar në kundërshtim me nenin 59,62 të LPP dhe nenit 72 të po këtij Ligji.

Autoriteti kontraktues me dt.22.05.2019 ka marr vendim me të cilin kërkesën tonë për rishqyrtim e refuzon si të pa bazuar me që rast ka bërë:

-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe
-Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Ne si OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me këtë vendim sepse AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe vendimin e panelit shqyrtues. Vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-ës nuk ka rekomanduar AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit por ka rekomanduar ri-vlerësimin e tij.

AK me rastin Ri-vlerësimi nuk ka vepruar drejt sepse ri-vlerësimi nënkupton fazën zero dhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP nuk prejudikon se AK nuk ka të drejtë të shpërblej me kontratë OE të rekomanduar më parë me kontratë ashtu siq e parasheh neni 115.6 i LPP-ës.

Citat i nenit 105.6 të LPP-ës: "Një vendi i OSHP për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar".

AK me rastin e anulimit nuk ka dhënë arsye bindëse për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit por vetëm me një arsyetim se një dispozit e LPP kërkon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit shtrohet pyetja cila dispozit është kjo.

AK gjatë ri-vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 39 të RUOPP në veqanti me nenin 39.8 të RUOPP duke mos përdorur këtë dispozit ku udhëzohet AK si të veprojë në rastet e caktuara lidhur me sqarimin e tenderit.

Nga ky Udhëzues gjejmë se në rastet kur deklarata e konzorciumin nuk është konform kërkesave të DT AK ka të drejtën dhe udhëzohet se mund të kërkojen informata sqaruese, në rastin tonë një veprim të tillë AK nuk e ka ndërmarr.

Po ashtu edhe lidhur me referencat AK sipas këtij udhëzuesi në rast se ka pas paqartësi por edhe nëse mungojnë referencat sipas këtij udhëzuesi mund të kërkojen informata sqaruese.

AK me rastin e ri-vlerësimit ka dështuar në aplikim të nenit 72 për të sqaruar, kërkuar informacione nga ana e OE lidhur me referencat dhe kontratat e konzorciumit të rekomanduar për kontratë sepse nuk mund të kalohet tek OE tjetër apo të anulohet aktiviteti i prokurimit pa vlerësuar drejt interesin publik në pajtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues me rastin e anulimit nuk ka vepruar konform nenit 62 të LPP-ës sepse ne kemi qenë OE me qmim më të ulët dhe AK ka mund të përdor edhe nenin 59 dhe 72 në këtë rast ndaj ofertës tonë.

Bazuar në të cekuarat më lartë kërkojmë nga Paneli shqyrtues të marrë këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "NTP Begisholli & Conex Group" nga Ferizaj me aktivitetin e prokurimit për tenderin "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashtanjevë të Ferizajt-projekt 3 vjeçar " me nr. të prok. 615-17-3827-5-1-1.

2. Anullohet vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Asfaltimi i rrugës Pleshinë-Kashanjevë të Ferizajt- projekt 3 vjeçar " me nr.të prok. 615-17-3827-5-1-1 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

*Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjes së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpezimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender*

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjithi kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit,*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

OSHP

From: NTP Begisholli Company [begisholli@live.com]
Sent: Monday, June 3, 2019 4:50 PM
To: OSHP
Subject: Ankesa dhe Deshmia e Pageses per Projektin „ Asfalltimi i rruges Pleshine-Kashatanjeve te Ferizajt - Projekt 3 Vjeqar
Attachments: 1.jpg; 2.jpg; 3.jpg; 4.jpg; 5.jpg; Pagesa 1.jpg
Importance: High